

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 181 Rep.
Nr. 34 Kol.

KONTRATE SHITJEJE PJESESH KAPITALI

Sot, më datë 14 . 02 . 2003, përpara meje, Dilaver Ymeri, notere e Dhomes së Noterëve Tiranë, u paraqitën personalisht palët e mëposhtme:

1. Mirjana Kuka, shtetase shqiptare, lindur më 21.10.1964, në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 0433873, që këtu e më poshtë do të quhet **Shitësi**;

dhe

2. Dilaver Ymeri, shtetas shqiptar, lindur më __.__.1961, në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit nr.093763, që këtu e më poshtë do të quhet **Blerësi**;

Shitësi dhe *Blerësi* ranë dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1 - Qëllimi

Shitësi bie dakord që të shesë 50 pjesë të kapitalit që përfaqësojnë 50 % të kapitalit të shoqërisë që ai zotëron në shoqërinë "DIPLOMAT - H.Y" SHPK.

Blerësi pranon të blejë 50 pjesë të kapitalit që përfaqësojnë 50 % të kapitalit të shoqërisë të *Shitësit*.

Neni 2 - Përshkrimi

Shitësi është ortak i shoqërisë "DIPLOMAT – H.Y" SHPK, shoqëri e organizuar në bazë të ligjeve shqiptare, regjistruar në Regjistrin Tregtar me Vendimin nr.6746, datë 16.09.1993 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë dhe zotëron 50% të kapitalit të shoqërisë.

Në përputhje me këtë kontratë, *Shitësi* do të transferojë nëpërmjet shitjes 50% përqind të pjesëve të kapitalit të tij tek *Blerësi*, sipas vendimit të Ortakut të Vetëm lidhur me këtë transferim.

Që këtëj e tutje, Z. Dilaver Ymeri do të bëhet ortak i shoqërisë "DIPLOMAT-H.Y" SHPK, duke zotëruar 50 pjesë të kapitalit që përfaqësojnë 50 % të kapitalit të shoqërisë.

36

Neni 3 - Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Shitësi garanton Blerësin se pjesët e kapitalit janë të transferueshme dhe të lira nga çdo barrë.

Neni 4 - Cmimi, Pagesa

Shitësi i shet Blerësit pjesët e sipërpërmendura të kapitalit me një çmim që përbëhet nga vlera nominale e tyre.

Çmimi është paguar jashtë ambienteve të kësaj zyre.

Neni 5- Mosmarrëveshjet

Mosmarrëveshjet që lindin nga kjo kontratë do të zgjidhen me mirëkuptim nga palët, në rast të kundërt do t'i drejtohen Gjykatës kompetente shqiptare.

Neni 6- Të ndryshme

Kjo kontratë është hartuar dhe do të interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Kjo kontratë është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe secila me të njëjtën vlerë ligjore.

Unë, noterja, pasi u binda për identitetin e palëve dhe aftësinë e tyre për të vepruar dhe pasi ua lexova përmbajtjen e kësaj kontrate me zë të lartë, kostatova se ajo vinte në përputhje me qëllimin e tyre dhe pasi ata e nënshkruan atë rregullisht përpara meje, unë, noterja vërtetoj nënshkrimin e tyre sipas ligjit.

SHITESI

Zj. Mirjana Kuka

BLERESI


Z. Dilaver Ymeri

Mirjana YMERI KUKA

Dilaver Ymeri

NOTERE

Donica Rousi



37